

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Trepça -Ndërmarrje në Administrim të AKP

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: ST 17 067 121

Sa i përket tenderit për Furnizim me pjesë rezervë për Ngarkuesit nëntokësorë ST 2D

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI  
Nr/B: 153/17  
Datum: 25.05.2017  
PRISHTINË - PRISTINA

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Almakos Group sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ilaz Kodra No. 5

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Petrit Doli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

almakosgroup@gmail.com

(Adresa elektronike)

24.05.2017

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe veta)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjiur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim për Kontrate me date: 27.03.2017

Njoftim për dhënie të Kontrates me date: 11.05.2017

Afati i fundit për dorëzimin e dosjes së tenderit: 18.04.2017 ora: 13:00

Kriter për dhënie të kontratës: Cmimi më i ulët

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

CMC-EKOCON sh.p.k. - Prishtine	49,288.63
NPT A-com- Mitrovice	45,409.90
Segment Kosova – Prishtine	49,438.00
Almakos Group shpk – Prishtine	43,270.28

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?



*Ne kemi bere kerkese per qishyrtim prane AK, por na eshte kthyer pergjigje se nuk mund te rishqyrtohet kerkesa me arsyen se eshte bere kerkesa pas afatit te parapare,  
Por ne nuk kemi pranuar Letren Standarde per tenderuesin e pasukseshem nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe per kete arsye kemi kerkuar pergjigje nga ana e AK.  
Te bashkangjitur mund te gjeni Kopjen e Kerkeses per Rishqyrtim prane AK.*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne baze te ligjit te Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Ne nuk kemi pranuar letren standarde për eliminim nga Tenderi nga ana e Autoriteti Kontraktues. Ne jemi njoftuar për dhënie të kontratës vetëm përmes platformës elektrike e-prokurimi me date 11.05.2017.

Dhe ne nuk e dijme arsyen pse neve nuk na është dhënë kontrata edhe pse kemi qene me lire për 6,167.72 Euro, ku edhe ne vitet e kaluara për pjese rezerve te ngjashme ne kemi furnizuar rreth 5 – 6 vite dhe nuk kemi pasur asnjë reklamacion nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Me date 22.05.2017 kemi bere kerkese për qasje ne dosje te tenderi te operatorit ekonomik fitues “Segment Kosova” dhe me date 23.05.2017 kemi marre pjesë ne qasje te dosjes se tenderit;

Gjate shikimit te dosjes se tenderit kemi vene re se OE fitues “Segment Kosova” ka certificate te prodhuesit ISO 9001:2008 me afat te skaduar te viti 2012.

Nga Autoriteti Kontraktues është kërkuar Autorizimi dhe Certifikata ISO nga Prodhuesi Atlas Copco, ku ne këtë rast është favorizuar vetëm një prodhues,

Ne baze te kësaj është shkelur Neni 7 Barazia ne Trajtim/ jo – Diskriminimi.

Ne ju informojmë se ne jemi distributor i autorizuar nga prodhuesi Vikay, po ashtu kemi edhe certifikatën ISO.

Andaj ne kërkojmë qe Autoriteti Kontraktues qe te kthej lenden ne Rivlerësim.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

--

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*